



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 567/4 Prot

Tiranë, më 16/4/2021

VENDIM

Nr. 24, datë 16.4.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. (në vijim “ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 567 Prot., datë 25.03.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Fondi Shqiptar i Zhvillimit (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet e-mail-it datë 23.02.2021, depozituar në adresën sdemko@albanianidf.org, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni si vijon:

1. Detajimin e planit buxhetor dhe realizimin e tij për pagesat e kryera në nivel projekti sipas VKM-ve të rindërtimit:
 - a. Pagesat mujore dhe numri i përfituesve për bonus qeraje çdo muaj.
 - b. Pagesat e kryera (grantet e rikonstruksionit) ndaj qytetarëve për dëmtimet në nivel DS1-DS3 në nivel mujor në vlerë monetare dhe individ përfitues.
 - c. Pagesat e kryera për rregullimet e pallateve të dëmtuara në nivel DS1-DS3.
 - d. Pagesat e kryera për rindërtimin e pallateve me dëmtime të rënda DS4-DS5.
 - e. Pagesat e kryera për rindërtimin e banesave individuale.
 - f. Pagesat e kryera për rindërtimin e objekteve publike (shkolla, spitale, qendra shëndetësore etj.)
2. Për fondet e alokuara me VKM për të cilat jeni njësi zbatuese, listën e çeljeve buxhetore në nivel projekti investimi të detajuar sipas viteve (2020,2021,2022).

3. Listën e urdhër-prokurimeve (me datë dhe objekt urdhri) me vlera përkatëse në nivel projekti investimi për procedura prokurime të kryera në funksion të rindërtimit.
4. Për secilin projekt investimi në zbatim të rindërtimit për të cilat jeni përgjegjës, listën e kontratave/angazhimeve buxhetore me datë e lidhjes së kontratës, datën e përfundimit të saj, objektin e kontratës, vlerën e plotë të kontratës, subjekti fitues i kontraktuar dhe detajimin e vlerës së plotë sipas viteve të zbatimit [2020, 2021, 2022].
5. Për secilën nga kontratat e lidhura në zbatim të procesit të rindërtimit, na detajoni pagesat e kryera nga sistemi i thesarit për vitin fiskal 2020.
6. Një kopje të regjistrimit të plotë të realizimit të prokurimeve për vitin 2020 ku përfshihen të gjitha prokurimet e realizuara nga institucioni juaj.

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 11.03.2021 ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion si dhe ka informuar ndër të tjera se: “...Lidhur me pikën 5 orientohuni pranë Departamentit të Thesarit, si struktura përgjegjëse e menaxhimit të sistemit të informacionit financiar. Për çështjet e parashtruara në pikat 3, 4 dhe 6 drejtohuni për informacion pranë Agjencisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al dhe buletinit të publikuar nga ky institucion.”

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, pretendon se ajo nuk është e plotë dhe kërkon nga Zyra e Komisionerit, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së dokumentacionit për pikat 3, 4, 5 dhe 6 të kërkesës për informacion, nga Autoriteti Publik.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 567/1 prot., datë 29.03.2021 kërkoi qëndrimin e Autoritetit Publik, në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1243/1 Prot., datë 06.04.2021, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 567/2 Prot., datë 07.04.2021, ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: “...në vijim të kërkesës së z. Joel Çela, më datë 23.02.2021 përmes postës elektronike, kërkesë për të cilën Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka kthyer përgjigje më datë 11.03.2021, sqarojmë se, lidhur me objektin e kërkesës (pika 3) “Listën e urdhër - prokurimeve (me datë dhe objekt urdhëri) me vlera përkatëse në nivel projekti investimi për procedura prokurime të kryera nga ju në funksion të rindërtimit”, neni 60 i VKM-së

nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar citon: Neni 60 "Urdhri i prokurimit":

Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

Në kuptim të këtij neni, të gjithë elementët e Urdhrit të Prokurimit janë pasqyruar nga ana e Fondit Shqiptar të Zhvillimit në Dokumentat Standarte të Tenderit, për çdo procedurë prokurimi. Këto dokumenta janë bërë publike në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), të cilat kërkuesi mund ti gjejë lehtësisht. Njëkohësisht, objekti i kërkesës (në pikat 4, 6) është pasqyruar nga ana e Fondit Shqiptar të Zhvillimit nëpërmjet "Njoftimit të kontratës së nënshkruar", publikuar nga APP për çdo procedurë prokurimi.

Përsa kërkohet në pikën 5, detajimi i pagesave të kryera nga sistemi i Thesarit për vitin fiskal 2020, është informacion që merret pranë Degës së Thesarit si struktura përgjegjëse e menaxhimit të sistemit të informacionit financiar.

Për sa kohë ky informacion është bërë publik nga ana e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, mund të gjendet lehtësisht nga kërkuesi në faqen zyrtare të APP".

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin citohet se: "Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", si edhe bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore.

Duke pasur parasysh situatën e krijuar si pasojë e përhapjes së COVID-19, në zbatim të masave të marra nga institucionet përkatëse, seanca dëgjimore u zhvillua nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik (on-line/video-call), në datën 13.04.2021, ora 11.30 me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesëve të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër, si dhe sqaruan ndër të tjera se: "...korrespondenca dhe praktika e plotë e ndjekur me ankuesin fillon më datën 5 shkurt 2021, për të cilën Fondi Shqiptar i Zhvillimit (në vijim, "FSHZH") ka kthyer përgjigje më datë 19.02.2021. Kërkesa e dytë ka vijuar më datë 23.02.2021, për të cilën FSHZH ka kthyer përgjigje më datë 11.03.2021. Praktika e paraqitur gjatë seancës dëgjimore nuk është e plotë. Për sa më sipër është tejkalluar afati ligjor për ankimim..."

Në përfundim të seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit i kërkoi përfaqësuesve të Autoritetit Publik të paraqesin në formë shkresore përmbledhjen përfundimtare në lidhje me ankesën, brenda datës 14.04.2021.

Në vijim, Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1243/2 Prot., datë 14.04.2021, vënë në dispozicion me e-mail-in datë 14.04.2021, rikonfirmoi qëndrimin e mbajtur në seancë dëgjimore, si edhe aktet shkresore të sipërcituara, duke pretenduar ndër të tjera se: *"...Komisioneri duhet të vendosi mos pranimin e ankimit si i paraqitur jashtë afateve ligjore. Gjithashtu, lidhur me objektin e kërkesës 1 dhe 2, nënvizojmë se FSHZH në asnjë moment nuk ka refuzuar dhënien e informacionit, por është përgjigjur brenda afatit ligjor si dhe ka orientuar z. në marrjen e informacionit në institucionet përkatëse. Konkretisht referuar nenit 16, pika 2 e LDI specifikohet se: Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni.*

Në këtë kuadër për pikat 3, 4, 6 FSHZH e ka orientuar ankuesin pranë faqes zyrtare të APP, ku gjendet i publikuar i gjithë informacioni nga ana e FSHZH dhe gazetari apo çdo qytetar/person i interesuar mund të gjejë lehtësisht këtë informacion. Programi i Rindërtimit nuk është i kufizuar dhe i shkëputur vetëm pranë FSHZH, por është ndërveprim mes disa aktorëve ku përfshihen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Rindërtimit, Instituti i Rindërtimit etj, sejcili me kompetencat e tij ligjore parashikuar në VKM-të përkatëse në kuadër të Rindërtimit. Në këtë kuadër, për pikën 5 kërkesa është orientuar pranë Degës së Thesarit si institucioni kompetent në dhënien e këtij informacioni..."

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, fillimisht, për sa i përket kërkesës së Autoritetit Publik se Komisioneri duhet të vendosi mos pranimin e ankimit si i paraqitur jashtë afateve ligjore, ky pretendim është i pabazuar.

Afati i depozitimit të ankesës është verifikuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka rezultuar në përputhje me parashikimet e pikës 2 të nenit 24 të LDI, në të cilën parashikohet se: *"Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit."*

Në lidhje me pikat 3, 4, 6 të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik pretendon se në asnjë moment nuk ka refuzuar dhënien e informacionit por është përgjigjur brenda afatit ligjor, si dhe ka orientuar në përputhje me pikën 2 të nenit 16 të LDI ankuesin pranë faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, aty ku ndodhet informacioni.

Komisioneri vlerëson se, ky pretendim i Autoritetit Publik nuk qëndron pasi konstatohet se kërkuesit i është vënë në dispozicion vetëm faqja zyrtare e institucionit ku pretendon se është publikuar informacioni dhe jo adresa e saktë e faqes ku ndodhet informacioni, në kundërshtim kjo me pikën 2 të nenit 16 të LDI, në të cilën parashikohet se:

2. "Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni..."

Për sa i përket pikës 5 të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik argumenton se ankuesi është orientuar për të marrë informacionin pranë Departamentit të Thesarit, si struktura përgjegjëse e menaxhimit të sistemit të informacionit financiar, duke mos respektuar në këtë mënyrë parashikimet ligjore në pikat 2 dhe 3 të nenit 12 të LDI, ku parashikohet se:

2. *“Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin.*

3. *Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.”*

Gjithashtu dhe në germën “d” të pikës 2, të nenit 10 të LDI, sipas të cilit *“koordinatori për të drejtën e informimit dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.*

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjislationit përkatës, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, ku parashikohet se: *“informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”. Rrjedhimisht, në përputhje me nenet 12, 14 dhe 16 të LDI, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuuesit çdo dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar ose t’u dërgojë atë pranë autoritetit kompetent në rastet kur nuk e zotëron informacionin duke vënë në dijeni edhe kërkuuesin.*

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve. Konkretisht në pikën 2, të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”*.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 567 Prot., datë 25.03.2021 të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Fondi Shqiptar i Zhvillimit”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit bazuar në kërkesën për informacion datë 23.02.2021, në formatin e disponuar, konkretisht:
(3. Listën e urdhër-prokurimeve (me datë dhe objekt urdhri) me vlera përkatëse në nivel projekti investimi për procedura prokurime të kryera në funksion të rindërtimit.
4. Për secilin projekt investimi në zbatim të rindërtimit për të cilat jeni përgjegjës, listën e kontratave/angazhimeve buxhetore me datë e lidhjes së kontratës, datën e përfundimit të saj, objektin e kontratës, vlerën e plotë të kontratës, subjekti fitues i kontraktuar dhe detajimin e vlerës së plotë sipas viteve të zbatimit [2020, 2021, 2022].
5. Për secilën nga kontratat e lidhura në zbatim të procesit të rindërtimit, na detajoni pagesat e kryera nga sistemi i thesarit për vitin fiskal 2020. 6. Një kopje të regjistrit të plotë të realizimit të prokurimeve për vitin 2020 ku përfshihen të gjitha prokurimet e realizuara nga institucioni juaj), brenda datës 23. 4 .2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 16. 4 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

